

Bazuar në nenin 17 pika b) dhe j) e Statutit të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.Prishtinë, neni 8 i Ligjit 03/L-212 i Punës, Rregullores nr.02/308 dt.04.03.2025 për Themelimin e marrëdhënies së punës në Ndërmarrjen Publike "Stacioni i Autobusëve" sh. A prishtinë Rregullores nr.02/147 datë 31.01.2025 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës, Rregulloren nr.02/527 dt.25.06.2018 për përcaktimin e pagës dhe çështjeve tjera të suksesit të punës së punëtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.Prishtinë me të gjitha plotesim/ndryshimet, Vendimin nr.02/1057 datë: 19.06.2025, UD Kryeshefi Ekzekutiv SHPALL:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Arkatar – 3 Pozita pune.

Kohëzgjatja e Kontratës së punës: Me Kohë te Pacaktuar, ndërsa puna provuese 3 deri në 6 muaj;

Paga Mujore: 701.5€.

Përshkrimi gjeneral: Pranon pazarin pagesat ditore, urdhëresat e arkës për pagesa dhe inkasime.

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Pranon pazarin pagesat ditor, urdhëresat e arkës për pagesa dhe inkasime;
- Dorëzon –deponon mjete pazarin në xhirollogarinë ankare të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për të hollat dhe letrat me vlerë i te cilat i disponon
- Bën regjistrimin me kod (identifikimin) të klientit, regjistrimin dhe numërimin e parave, si dhe regjistrimin e pagesave në kompjuter. Pranon informacione të ndryshme lidhur me problemet e konsumatorëve dhe për të njëjtat e njofton Udhëheqësin e Arkës dhe Llogaritjes së Pagave;
- Përgatitë raportet e pagesave dhe të njëjtat menjëherë i dorëzon në shërbimin e kontabilitetit me qëllim të regjistrimit të pagesave;
- Kryen edhe punë të tjera nga fusha e veprimtarisë së vet dhe punë të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit.

Kualifikimet dhe Aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Përvojë pune 1 (një) vjeçare.
- Aftësi komunikimi me klientë;
- Njohja e punës me kompjuter.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Aplikacioni i Punësimit të plotësuar;
2. CV e aplikantit.
3. Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimin të kopjuar.
4. Dëshmia e kualifikimit shkollor;
5. Kopjet e certifikatave, referencave tjera profesionale që ndërlidhen me pozitën që aplikoni.
6. Dëshmit mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust.
7. Dëshminë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedure penale ndaj tij/saj, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikimi për konkursin e shpallur duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike, aplikacioni merret në faqen zyrtare të ndërmarrjes www.sap-rks.com – vegza “Konkurse” dhe dorëzohet në adresën elektronike: konkurse@sap-rks.com;
- Dokumentet duhet të bashkangjiten sipas kërkesave të konkursit në versionin PDF.
- Pas aplikimit të suksesëshëm do të pranoni një email konfirmues.
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim;
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve të rinj;

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

- Mënyra e vlerësimit do të bëhet në bazë të Rregullores nr.02/308 dt.04.03.2025 për themelimin e marrëdhënies së punës në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë, neni 19.
- Vlersimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit.
- Për pozitën të cilat kërkohet testimi me shkrim, jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë dhe intervistimi deri në njëzetë (20) pikë

Kalendari i përafërt i përfundimit të procedurës së rekrutimit:

- Bazuar në diapozitat e Rregullores nr.02/308 dt.04.03.2025 për themelimin e marrëdhënies së punës në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë, neni 10 pikë 10.5 afati për marrjen e vendimit për përzgjedhjen të kandidatit të përshtatshëm është 30 ditë që nga dita mbyllja e konkursit për pozitën e punës “Arkatar”.

Mënyra e njoftimit për rezultatet e konkursit:

- Kandidatët për rezultatet e fazave të procedurës së rekrutimit do njoftohen në mënyrë individuale dhe në formën elektronike.

Konkursi është i hapur 15 ditë duke përfshirë ditën e publikimit nga dt: 20.06.2025 deri më datë:04.07.2025 në ora: 16:00h.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.